

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 E martë, 21 shtator 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca hapet në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita. Mirë se erdhët.

7 Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit, zonja Sekretare.

13 U lutem tani palëve, Mbrojtëses së Viktimave dhe Zyrës
14 Administrative që të prezantohen duke filluar nga Zyra e
15 Prokurorit të Specializuar. Keni fjalën.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mirëdita
17 të gjithëve, sot Prokuroria përfaqësohet nga unë, Cezary
18 Michalczuk, prokuror, nga Silvia D'Ascoli, ndihmësprokurore,
19 Filippo de Minicis, një tjetër ndihmësprokuror, Alex Whiting,
20 zëvendës Prokuror i Specializuar dhe Julie Mann, që është
21 menaxhere e lëndës.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Mbrojtësja e Viktimave?

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve. Mirëdita të

1 nderuar gjykatës. Ekipi ynë përfaqësohet nga Lisbeth Zegveld,
2 bashkëmbrojtësja, Mari-Pier Barbeau, nëpunëse juridike dhe nga
3 unë, Annie Pues.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Mbrojtja?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
7 Mbrojtja përfaqësohet nga unë, Julius Von Bone, kryeavokati,
8 bashkëavokati, zoti Betim Shala, dhe hetuesi Fatmir Pelaj. Siç
9 mund ta shihni sot është i pranishëm edhe i akuzuari në sallën
10 e gjyqit.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
12 hir të proces verbalit, kolegët e mi janë Gjykatës Rolad
13 Dekkers, Gjykatës Gilbert Bitti dhe Vladimir Mikula, Gjykatës
14 rezervë, dhe unë jam Mappie Veldt-Foglia, kryegjykatëse.
15 Trupi Gjykses Nr. 1.

16 Përpara se të vijojmë me marrjen e në pyetje të
17 dëshmitarit 3593 nga ZPS-ja, Trupi Gjykses dëshiron t'i
18 drejtohet zotit Mustafa.

19 Zoti Mustafa, Trupi Gjykses ka kërkuar praninë tuaj këtu
20 sot. E kërkoi dje këtë prani. Keni të drejtën që të mos
21 flisni, e kjo heshtje nuk do të merret parasysh në marrjen e
22 vendimit për pafajësinë apo fajësinë tuaj.

23 Dje ju bëtë të ditur për herë të dytë se nuk dëshironit
24 të merrnit pjesë në seancë. Kështu?

25 I AKUZUARI: A mund të marr fjalën, zonja Gjykatëse?

1 E nderuara zonja Gjykatëse. Faleminderit për mundësinë që
2 më dhatë për t'u shprehur.

3 Që në fillim po ju them se as dëshira ime dhe as qëllimi
4 im nuk është që të mos ju respektoj ju dhe Panelin e kësaj
5 Gjykate. Por as zonjën avokate --

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
7 Mustafa, mund të flisni paksa më ngadalë sepse duhet
8 përkthyer.

9 I AKUZUARI: Që në fillim po ju them se as dëshira ime e
10 as qëllimi im nuk është që të mos ju respektoj ju, dhe Panelin
11 e kësaj Gjykate, por as zonjën avokate që është ulur atje
12 përballë. Sepse nuk është as në bindjen time e as në kulturën
13 time. Por kohët e fundit më është shkaktuar një stres dhe ky
14 stres po vjen si pasojë e disa faktorëve të ndryshëm dhe tani
15 po jua them se cili është problemi.

16 Pas 12 muajve në paraburgim unë në fundjavën e kaluar
17 pata vizitën e parë fizike me fëmijët e mi dhe gruan time.

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR].

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
2 Mustafa, do të kalojmë në seancë private dhe në momentin që do
3 të kalojmë në seancë private, do të vijoni.

4 Zonja sekretare, a mund të kalojmë në seancë private ju
5 lutem?

6 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
9 Mustafa mund të vijoni.

10 I AKUZUARI: Prandaj, e nderuar zonja Gjykatëse, kjo
11 situatë shkaktoi stres edhe tek unë por edhe te fëmijët e mi.

12 Arsyeja e dytë: Gjatë ditës nuk mundem të marr telefonata
13 të shpeshta as me fëmijët dhe as me gruan. E kam vetëm një
14 moment të caktuar, që caktohet kur të dëshirojë drejtori i
15 paraburgimit. Për shembull, unë e di përafërsisht orarin e
16 fëmijëve të mi, unë e di që fëmijët e mi në orën 6 ose në 12
17 të ditë, shkojnë në futboll ose në aktivitetet e tyre të
18 përditshme. Prandaj nëse dua të flas me fëmijët në orën 10 në
19 mëngjes ai thotë nuk mundesh dot të flasësh në orën 1.00. Në
20 orën 1 fëmijët e mi janë nëpër aktivitete.

21 Ushqimin që e marr, e marr njëherë në ditë për 24 orë.
22 Prandaj po them më vjen keq, por jam duhanxhi i rëndë dhe i
23 pasionuar.

24 E di që është shprehi e keqe, por unë kam tepër të
25 zorshëm koncentrimin në qoftë se nuk kam pushim për cigare dhe

1 të gjitha këto së bashku ditët e fundit po më shkaktojnë stres
2 të madh.

3 Të gjitha këto janë ngarkesë shtesë, duke marrë parasysh
4 edhe urdhrin për veçim që nga data 20 gusht që po e ngarkojnë
5 gjendjen time mendore.

6 Sepse unë momentalisht jam i izoluar brenda paraburgimit.
7 E ndjej veten shumë më të relaksuar nëse marr pjesë në seancat
8 gjyqësore përmes videolidhjes. Mundem të përqendrohem më mirë
9 në të gjitha çështjet që fliten këtu në këtë Gjykatë.

10 Në këtë mënyrë pra përmes videolidhjes e kam më të lehtë
11 dhe besoj se nuk më shpërqendron dhe jam më i koncentruar.
12 Sepse po që se e përcjell seancat përmes videolidhjes gjatë
13 pauzave unë mund të pi cigare por mund edhe të ha diçka.

14 Më shkurt e ndjej veten më rehat nëse seancat më
15 mundësohen të përcillen përmes videolidhjes. Prandaj mosprania
16 ime në seanca fizikisht në asnjë mënyrë nuk tregon mosrespekt
17 dhe nuk duhet të kuptohet si mos respekt ndaj Gjykatës dhe
18 dëshmitarëve. Ka shumë dëshmitarë të Prokurorisë prandaj kjo
19 mungesa ime nuk do të jetë e përhershme, por besoj se disa
20 dëshmitarë janë më të rëndësishëm se disa të tjerë për rastin
21 tim.

22 Prandaj ju lutem kuptojeni se mungesa ime në seancën
23 gjyqësore nuk është pjesë e ndonjë strategjie. Plotësisht se
24 juve kjo mund t'ju tingëllojë e çuditshme, por me të vërtetë
25 mendoj se është më mirë se në rrethanat që unë jam këtu, se

1 seancat t'i përcjell përmes videolidhjes.

2 Nuk do të jap ndonjë deklaratë që nuk është nën betim.

3 Prandaj këtë që po them sot duhet të shihet si një deklaratë e
4 dhënë jo nën betim. Deklaratën jo nën betim do t'ja besoj në
5 një fazë të mëvonshme të procedurës.

6 Dhe përfundimisht nëse më lejohet të marr pjesë përmes
7 videolidhjes, ecuria e procedurës besoj do të shkojë më lehtë.
8 Unë me të vërtetë besoj se kjo rreptësia e veçimit për ndarje
9 në kushte praktike po del shumë kundërproduktive. Ndoshta ju
10 po e arsyetoni këtë me mbrojtjen e mëtejshme dhe më të fortë
11 të dëshmitarëve por para së gjithash edhe unë jam qenie
12 njerëzore, nuk jam robot dhe kjo po më shkakton shumë stres,
13 mungesë koncentrimi dhe po e ndjej veten nën presion të
14 vazhdueshëm.

15 Prandaj edhe në fund po ju them në qoftë se Gjykata apo
16 avokatja e viktimave e ka marrë si jo respekt apo injorim, e
17 them edhe një herë me bindje dhe sinqeritet se kjo nuk ka
18 ndodhur nga ana ime dhe nuk ndodh as në të ardhmen.

19 Dhe siç e thashë më lartë, faktorë janë të tjerë dhe nuk
20 kanë të bëjnë me rastin tim që po zhvillohet në këtë Gjykatë.

21 Faleminderit, zonja Gjykatëse.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit zoti Mustafa. Ky është gjykimi juaj, është e
24 rëndësishme për këtë arsye që të jepni sqarime lidhur me
25 arsyet përse nuk doni të ishin në sallë, pra ishte e

1 rëndësishme.

2 Më lejoni që t'ju edhe disa pyetje të tjera, nëse do të
3 ju jepej mundësia që të pinit duhan këtu në mjediset e
4 Gjykatës, a do ta ndryshonte kjo kërkesën tuaj?

5 I AKUZUARI: E keni fjalën gjatë pauzave, apo jo?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
7 për atë e kam fjalën.

8 I AKUZUARI: Besoj do të ishte më e lehtë për mua, shumë
9 më e lehtë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra
11 shoh dy kërkesa atëherë në këtë rast nga ana juaj. Njëra është
12 nëse do t'ju lejohej që të pinit duhan gjatë pushimeve në
13 mjediset e Gjykatës gjatë ditëve që bëjmë seancë, ju do të
14 vinit këtu në seancë apo jo?

15 I AKUZUARI: Po mundësisht, e nderuar zonja Gjykatëse,
16 edhe masat të më zbuten. Qëndrimin ditor timin në paraburgim,
17 të më jepet mundësia për të folur me fëmijët e mi në mëngjes,
18 domethënë gjatë ditës kur unë kam nevojë.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
20 kuptoj, por pyetja që bëra ishte një herë për këtë tjetrën, se
21 ju dëgjova se cila është kërkesa. Kemi marrë një vendim për
22 këtë dhe kam mbajtur një shënim për këtë.

23 Por pyetja që ju bëra pak më parë është kjo: nëse do t'ju
24 jepej mundësi që të pini duhan këtu, a do të vinit këtu apo
25 jo?

1 I AKUZUARI: Nëse ju e shikoni të arsyeshme, Gjykatëse,
2 unë vij.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
4 dëgjova gjithashtu që bëtë kërkesë për videolidhje,
5 videolidhje në objektin e paraburgimit. Me sa ju kuptova nuk
6 është se do të jetë e përhershme pra nuk është se do të jeni
7 gjithmonë, do ta ndiqnit gjyqin gjithmonë prej objektit të
8 paraburgimit por do të vini këtu, pra ndonjëherë do të vini
9 dhe ndonjëherë jo.

10 E kuptova qartë? E shikoj që tundni kokën.

11 I AKUZUARI: Po.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
13 Sigurisht do t'ju duhet që të na informoni paraprakisht për
14 këtë. E kuptoni këtë?

15 I AKUZUARI: [E padëgjueshme].

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra
17 nëse do të vendosni kështu, sepse unë do të kërkoj edhe
18 parashtrimet e Zyrës së Prokurorit edhe të Mbrojtëses së
19 Viktimave, sepse ajo që ndodhi edhe të mërkurën edhe dje nga
20 këndvështrimi praktik, nëse vjen një moment dhe zhdukeni,
21 krijon një lloj çorganizimi për gjyqin, një gjë të cilën unë
22 nuk do të doja që të ndodhte përditë.

23 E kuptoni këtë?

24 I AKUZUARI: E kuptoj, zonja Gjykatëse, besoj se ka qenë
25 keqkuptim dhe besoj që ka qenë si pasojë e mosnjohjes së

1 rregulloreve, të rregullave të cilat janë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo
3 që ne vumë re dhe është se do të ishit, menduam se do të ishit
4 pas dreke dhe pastaj na u tha që nuk ishit. E njëjta gjë edhe
5 të mërkurën.

6 Nuk do të donim që të vazhdonim kështu.

7 I AKUZUARI: E nderuar zonja Gjykatëse, humba koncentrimin
8 kisha nevojë për pushim.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
10 dëgjova fjalën tuaj lidhur me situatën e stresuar në të cilën
11 ndodheni. Do të jetë pjesë e argumenteve që do të marrim në
12 shqyrtim.

13 Tani, një herë për një herë dua që të pyes Prokurorinë
14 edhe Zyrën e Mbrojtjes së Viktimave çfarë mendimi kanë sa i
15 takon pranisë ose jo, megjithëse kemi rregullën 68 të
16 Tregullores që është e qartë sa u takon të drejtave të të
17 akuzuarve. Megjithatë do të doja t'ju dëgjoja ç'mendim keni
18 për këtë dhe për mundësinë e pjesëmarrjes me videolidhje në
19 objektin e paraburgimit, sepse sipas kuadrit ligjor të Dhomave
20 të Specializuara nuk është e parashikuar shprehimisht dhe nuk
21 e kam fjalën për fazën paraprake për të marrë pjesë përmes
22 videolidhjes, me përjashtim të rregullës 68, paragrafi 6 i
23 kësaj rregulle, kur Trupi Gjykes i mundëson të akuzuarit që
24 të ndjekin procesin gjyqësor dhe t'i japë udhëzimet e veta
25 mbrojtjes së specializuar nga jashtë sallës së gjyqit, nëse i

1 akuzuari është i paraburgosur dhe fizikisht i pa aftë për të
2 qenë i pa aftë për të qenë i pranishëm në gjykim. Dhe po
3 kështu edhe kur i akuzuari nxirret nga salla e gjyqit për
4 shkak të sjelljes së pa hijshme, ndiqet po e njëjta mënyrë e
5 organizimit.

6 Ju kërkoj ndjesë. Por përpara se t'ju jap fjalën, po shoh
7 i drejtohem njëherë zotit Von Bone.

8 Krahas atyre që na tha klienti juaj, ka diçka tjetër që
9 doni të shtoni, apo dëshironi të paraqisni ndonjë kërkesë
10 zyrtare sa u takon atyre që sapo i shprehu klienti juaj?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] E nderuara Gjykatëse, dua të
12 shtoj edhe një herë se nuk është aspak një synim për të
13 penguar procesin, as dje as ditët e tjera. Është një çështje
14 organizative. Nëse mund të merren masa përkatëse, nga kjo mund
15 të përfitojë i akuzuari që edhe të ushqehet por edhe të ketë
16 kontakte gjatë pushimeve nëse mund të organizohet jo këtu, por
17 në objektin e paraburgimit, nëse këtu nuk janë mundësitë.

18 Mendoj se i ka shkaktuar shumë stres, rezultat i dukshëm
19 i masave që janë marrë. Edhe një herë, unë nuk mendoj se do të
20 ndodhë me të gjithë dëshmitarët, por siç e tha edhe vetë zoti
21 Mustafa, ka disa dëshmitarë për të cilët ai do të ishte i
22 pranishëm.

23 Por ajo që harrova të them është se gjatë pushimit të
24 drekës që është një orë e gjysëm, mund të bëjmë një takim në
25 Zoom me të për të qenë në kontakt me të, për të kryer

1 konsultime. Pra nga ana organizative nuk do të ishte fare
2 problem as për ne.

3 Thjesht desha që ta mbanit këtë parasysh. Mendoj se
4 prania e të akuzuarit përmes videolidhjes është një prani e
5 barabartë me praninë fizike në sallën e gjyqit. E kemi pasur
6 të njëjtën gjatë fazës së procedurës paraprake. Nuk kishte
7 asnjë problem kështu që nuk mendoj se do të shkaktojë asnjë
8 problem as në këtë rast.

9 Këtë desha të shtoj, krahas atyre që tha zoti Mustafa.
10 Nëse është mundësia, në funksion të ecurisë pa probleme të
11 procedurës, kërkesa mund të bëhet në këtë format dhe sigurisht
12 do t'ju informojmë sa herë, siç kemi vepruar edhe gjatë fazës
13 së procedurës paraprake, përmes një mesazhi që do të marrë
14 pjesë përmes videolidhjes apo përmes pranisë fizike.

15 Këto ishin parashtrimet e mia lidhur me këtë, nëse
16 dëshirohet ndonjë kërkesë, mund ta bëjë një kërkesë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
18 Faleminderit, zoti Von Bone.

19 Përpara se t'u kthehem Prokurorisë dhe Zyrës së
20 Viktimave, kam një pyetje për Zyrën Administrative.

21 A do të ishte e mundur që të organizohet jo vetëm
22 videolidhja nga objekti i paraburgimit, se këtë e di, jam e
23 informuar që ekziston, por edhe mundësia për të instruktuar
24 avokatët e Mbrojtjes, me një fjalë që të kenë kontakte
25 avokatët me klientët, sepse unë e dëgjova kur tha zoti Von

1 Bone që ekziston kjo mundësi por dua që ta dëgjoj edhe prej
2 jush se çfarë është e mundshme.

3 Z. ROCHE: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, kjo mund të
4 bëhet menjëherë. Masat janë marrë tashmë që klientët të
5 konsultohen me avokatët e tyre.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
7 Faleminderit.

8 [Trupi Gjykses këshillohet]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Prokuroria ka fjalën nëse kanë diçka për të thënë për këtë.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara
12 Gjykatëse.

13 Gjëja më e rëndësishme në këtë rast që i akuzuari të ketë
14 mundësinë të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë në proces. Dhe
15 pavarësisht nëse është i pranishëm këtu apo në distancë, kjo
16 nuk ka rëndësi. Ne ja lemë Trupit Gjykses të marrë vendimin në
17 këtë aspekt, por duhet medoemos të ketë të drejtën në çdo
18 moment, gjatë çdo seance, të konsultohet me avokatin dhe duhet
19 të ketë mundësinë që të bëjë pyetje nëse dëshiron dhe të ketë
20 mundësinë që të jetë i pranishëm, pavarësisht nëse kjo prani
21 është fizike apo jo, por siç e thashë, ky është një vendim që
22 i takon Trupit Gjykses.

23 Nëse do të merret vendim dhe këtë e nënvizoj, pra - nëse
24 do të ketë një vendim për t'i dhënë mundësi të akuzuarit të
25 marrë pjesë në distancë, mbase do të ishte e arsyeshme që të

1 verifikohej herë pas here që ekzistojnë apo përbushen kushtet
2 e pjesëmarrjes kuptimplotë, pra nëse ekziston mundësia e të
3 qëndruarit në lidhje midis të akuzuarit dhe avokatit të tij,
4 nëse vërtetë mund të bëjë pyetje përmes avokatit. Pra duhet
5 verifikuar në mënyrë periodike nëse këto kushte ekzistojnë,
6 sepse siç e thash pak më përpara, pjesëmarrja kuptimplotë e të
7 akuzuarit është shumë e rëndësishme.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit, zoti Prokuror.

10 Mbrojtësja e Viktimave, keni fjalën.

11 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po të nderuar Gjykatës, dhe zoti
12 Mustafa. Pikë së pari, të falënderoj për shpjegimin që dhe që
13 na ndihmon. Për sa i takon kërkesës, ka dy çështje që duhen
14 trajtuar. E para është gjendja e të akuzuarit në paraburgim
15 dhe gjatë pushimeve ku duhen bërë përpjekje mendoj që të
16 zgjidhet ky problemi i tij, pra që një duhanpirës të pij;
17 duhan. Sidomos kur bëhet fjalë për gjyqe që sigurisht kërkohet
18 më shumë -- vetë nuk pi por e kuptoj ç' do të thotë që ta lësh
19 dikë për një periudhë të gjatë kohe pa pasur mundësi pa pirë
20 duhan. Apo ushqime, për shembull, duhet të jenë të rregullta,
21 jo një herë në ditë. Pra janë disa probleme të cilat duhen
22 rregulluar që për mendimin tim, të gjitha këto pra kanë të
23 bëjnë me drejtësinë e procedurave.

24 Një tjetër është prania e të akuzuarit. Ligji thotë qartë
25 se prania fizike është qëllimi parësor, apo i procedurave

1 gjyqësore. Nëse nuk është e mundur për shkak të mungesës së
2 përqendrimit apo, siç dëgjuam, kushtet nuk lejojnë një
3 pjesëmarrje kuptimplotë, neve në këtë rast nuk do të
4 kundërshtojmë.

5 Një gjë tjetër që mendoj se është e rëndësishme është
6 njoftimi paraprak me qëllim që dëshmitarët e ardhshëm të
7 përgatiten për situatën në të cilën do të gjenden në sallën e
8 gjyqit dhe prania fizike e të akuzuarit është me rëndësi për
9 ta.

10 Unë jua lë ju në dorë të vendosni të nderuar Gjykatës,
11 por desha t'i shpreh ato mendime. Më lejoni të flas edhe një
12 herë.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ne
14 jemi këtu të mësojmë sa më shumë që të marrim një vendim të
15 mirë informuar.

16 ZNJ. PUES: [Përkthim] Ka edhe një gjë tjetër që ka të
17 bëjë me gabimet teknike që mund të ndodhin kur kemi një
18 videolidhje. A mund të sigurojmë që kur të jetë e nevojshme
19 pamja të jetë e qartë. Në qoftë se ka një pengesë fizike, ajo
20 është aty. Gjëra të tilla pra, a ka një sistem monitorimi të
21 qartë që të mos ketë të meta teknike, sepse ne e dimë që
22 sistemet e teknologjisë së informacioneve janë të brishta. Ne
23 kemi pasur shumë probleme gjatë kësaj kohe, që nuk është faji
24 i askujt, por thjesht desha ta vija në dukje që të merret
25 parasysh.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit për këtë vëzhgim, mund të them se Gjykata bën
3 maksimumin e vet për t'u siguruar që të mos ketë probleme.

4 Tani i shkëmbyem mendimet, parashtrimet me gojë për këtë
5 pikë. A ka gjë tjetër?

6 Shikoj që keni ngritur dorën, zoti Von Bone.

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, siç e morët vesh klienti pi
8 shumë duhan dhe sigurisht nuk mund të pij; cigare gjatë
9 seancave këtu. Sa për ta sqaruar, mund të pijë kur të kemi
10 kontakt nëpërmjet Zoom, po jo këtu.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit që e shpjeguat.

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra deri tani nuk kemi pasur
14 probleme me seancat me Zoom, prandaj mendova që zbatimi i
15 lidhjes me video nuk besoj që të ketë ndonjë problem.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni
17 shkëmbyer mendimet tuaja me gojë këtu në Gjykatë. A ka ndonjë
18 nevojë që të bëni edhe parashtrime me shkrim apo mjafton këto
19 që thamë, pra ato që duheshin thënë i thatë?

20 Prokurori i Specializuar, Avokati i Viktimave, Zoti Von
21 Bone? Asnjëri me sa shoh.

22 Ne do të marrim një vendim për këtë, do ta bëjmë këtë sa
23 më shpejt. Vendimi mund të jetë me shkrim, por mund të jetë
24 edhe një urdhër me gojë. Do të mendohemi, do të reflektojmë
25 para se të marrim vendim.

1 Tani do të vazhdojmë me seancën dhe me pyetjet e
2 dëshmitarit, pra të vazhdojmë siç e kishim parashikuar sot në
3 planin e punës. Tani t'i kthehemi dëshmisë së dëshmitarit 3593
4 dhe të kalojmë në seancë të hapur. Zonja sekretare, të lutem,
5 e shoh që po merr në telefon.

6 Të kalojmë pra në seancë të hapur.

7 [Seancë e hapur]

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 jemi përsëri në seancë të hapur.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Tani t'i kthehemi dëshmitarit, dëshmisë së tij, pra. Ju
13 lutem silleni dëshmitarin në sallën e gjyqit.

14 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
16 Dëshmitar, mirëmëngjesi, mirë se ke ardhur. Si je sot? A
17 pushove?

18 DËSHMITARI: [E padëgjueshme].

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
20 mirë. Z. Dëshmitar, tani e ka fjalën Prokurori për të
21 përfunduar pyetjet dhe më lejo të të kujtoj se vazhdon të jesh
22 ende nën betim për të thënë të vërtetën. E kupton këtë?

23 DËSHMITARI: [E padëgjueshme].

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
25 prokuror, e ke fjalën. Ke tre orë e 30 minuta të mbetura nga

1 koha prej 7 orësh.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

3 DËSHMITARI: W03594 [Vazhdimi]

4 Marrje në pyetje nga Z. Michalczuk:

5 Py. Mirëmëngjesi, zoti Dëshmitar.

6 Pë. Do t'u bëj disa pyetje vijuese siç i quajmë ne, që kanë

7 të bëjnë me disa pjesë të dëshmisë që ke dhënë dje.

8 Dje na tregove se kishte një person dhe ti the se ai

9 personi kishte shenja djegieje në trup. Na the gjithashtu se

10 ky personi [REDAKTUAR] dhe nuk hante dot vetë.

11 Pyetja që kam për ty është kjo: përveç këtij personi që na the

12 që i kishte [REDAKTUAR], a kishte njeri tjetër në atë

13 haurin ku ju mbanin të lidhur si ai? A kishte njeri tjetër

14 [REDAKTUAR]?

15 Pë. Jo, vetëm ai ka qenë aty.

16 Py. Gjatë qëndrimit tënd në Zllash gjatë këtyre ditëve, a të

17 kanë çuar përpara ndonjë gjykatësi apo ndonjë prokurori

18 ndonjëherë?

19 Pë. Jo.

20 Py. Të lutem mendo pak për atë momentin që na përshkrove dje.

21 E kam fjalën për momentin që siç the ti, i [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]. Pyetja që kam për ty është

23 kjo, sepse dje the këtë: mbas përfundimit të rrahjes, dëgjo me

24 kujdes ç'ke thënë:

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 E mban mend që ke thënë, pra [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR].

4 Pë. [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR].

7 Py. Nuk po të pyes se [REDAKTUAR], sepse the që nuk i njihje

8 se [REDAKTUAR], dhe e kuptoj. Por pyetja ime ka të bëjë me

9 fjalën [REDAKTUAR] që the ti. [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 Pë. Po, q' ai që më ka rrah, ai i [REDAKTUAR].

13 Py. E kuptoj. Do të them një fjalë dhe të kërkoj ndjesë për

14 mënyrën se si do ta shqiptoj unë në shqip: fjala "skifterat",

15 çfarë do të thotë për ty, a e kupton ti çdo të thotë fjala

16 "skifterët" në këtë kuadër që po flasim?

17 Pë. Nuk e di, veç, unë veç kam ndi fjalë që skifterët se kush

18 janë, nuk e di. S'marr vesh unë atë punë.

19 Py. Kjo fjala "skifterë"t dhe i akuzuari -- a lidhet fjala

20 "skifterët" me të akuzuarin? Ka ndonjë lidhje midis tyre?

21 Pë. Po normale, ata jano konë, q' ata janë, a konë i akuzuari

22 a konë me "Skifterët".

23 Py. E kuptoj që ka qenë i akuzuari me skifterët, por ti si i

24 ke njohur, çfarë di të për këta skifterët?

25 Pë. Unë në atë kohë as e kom ditë. Mbas -- ma vonë e kom ndi

1 t'u i përmend që q'ata kanë qenë "Skifterët".

2 Py. A mund të sqarosh pak të lutem? The që "ata - aty

3 Skifterët" -- Për kë e ke fjalën? Për cilin vend? Për çfarë

4 momenti të kohës e ke fjalën?

5 Pë. Në momentin në q'atë vendin që më trajtuan, ata më vonë e

6 kam kuptuar se i kanë quajtu "Skifterët". Edhe sot nuk e di se

7 çka janë "Skifterët". Këtë nuk e di.

8 Py. Ti the që "ata ishin Skifterët". E ke fjalën për ata

9 njerëzit aty në Zllash ku të mbanin ty, për ata po flet?

10 Pë. Po.

11 Py. Tani do të bëj një pyetje. Këta "Skifterët", nëse e di

12 sigurisht, a ishin ndonjë fare njësitë?

13 Pë. Nuk e di se çfarë kanë qenë ata.

14 Py. Në rregull, kalojmë më tej. Z. Dëshmitar, tani do të të

15 tregoj një fotografi.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Sekretare, të lutem tregoj

17 edhe publikut këtë fotografi. Kjo fotografi është në grupin e

18 dokumenteve me numër SPOE00128386 deri në 0018420 në këtë gamë

19 dokumentesh dhe fotografi që do të tregoj ka këtë numër ERN:

20 SPOE00128388. Dhe ju lutem tregojani dëshmitarit këtë

21 fotografi.

22 E sheh dëshmitari këtë fotografi? Unë nuk e kam përpara

23 prandaj po pyes.

24 Është paragrafi 14. Për t'ja lehtësuar punën Mbrojtjes

25 për ta gjetur se ku është. E shoh tani, pra kjo është

1 fotografia.

2 Py. Z. Dëshmitar, a e ke përpara këtë fotografinë aty në

3 ekran?

4 Pë. Po.

5 Py. Çfarë tregon kjo fotografi?

6 Pë. Urdhro?

7 Py. Çfarë ka në atë fotografi?

8 Pë. Aty po ma merr mendja është vendi ku më kanë trajtu, aty

9 poshtë, në bodrum.

10 Py. Është ai vendi në Zllash ku të kanë mbajtur? Këtë po

11 thua?

12 Pë. Po.

13 Py. A mund t'i thuash Gjykatës se në cilën nga këto ndërtesa

14 -- sepse ti -- ka tre ndërtesa siç e sheh. Është një më e

15 lartë, një tjetër ngjitur që është pak më poshtë dhe pastaj

16 është ajo e treta që është me ngjyrë si të zezë. Pra pyetja

17 ime është kjo: a i thua dot Gjykatës se në cilën prej këtyre

18 ndërtesave të kanë mbajtur?

19 Pë. Në atë që po shihet me dy kate, që është, e ka bodrumin

20 poshtë. Unë kam ndenjtur në bodrum, gjatë kohës.

21 Py. E ke fjalën për atë ndërtesën që është më e ngritur në

22 krahun e djathë? Këtë po thua?

23 Pë. Po.

24 Py. Pra, po thua që të kanë mbajtur në bodrum, aty në haur të

25 kësaj ndërtesës?

1 Pë. Po.

2 Py. Dje na the se nga vendi ku të mbanin, bashkë me të
3 tjerët, dëgjonit zhurma, britma, thirrma të njerëzve lartë. A
4 mund t'i thuash Gjykatës nëse ky vendi lart që thua është te
5 kjo ndërtesë ku dëgjonin ju britmat?

6 Pë. Me fol drejt, besoj se ai vendi nalt është, se i kam
7 pasur sytë e mbyllur dhe s'kam mujt me pa kurrgjë, por me
8 siguri që ajo është, nalt.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
10 që t'i tregoj dëshmitarit një foto tjetër, por do t'i lutesha
11 Sekretares të mos e tregonte për publikun dhe kjo është
12 fotografia me numër 100968 dhe t'ua gjej tani numrin ERN. E
13 gjithë gama ERN është 100966-100969.

14 Për Mbrojtjen është paragrafi 12. Tani dua t'ja tregoj
15 dëshmitarit dhe të gjithëve që jemi këtu në sallën e gjyqit
16 këtë fotografi që sapo thashë me numër ERN 100968. Kjo është
17 fotografia.

18 Py. Z. Dëshmitar, a e shikon këtë fotografinë përpara?

19 Pë. Po.

20 Py. Kjo fotografi është e njëjta fotografi, por ka disa
21 ndryshime. A e shikon nënshkrimin tënd aty?

22 Pë. Po.

23 Py. Ka disa rrathë aty, e shikon? E shikon është një rreth i
24 madh që është rrethi kua ajo - është me ngjyrë blu. A të
25 kujtohet që ti vetë e ke bërë këtë rrethin?

1 Pë. Po.

2 Py. Çfarë është ajo ndërtesa që ke rrethuar, a mund të
3 shpjegosh?

4 Pë. Po unë tregova, q'ajo ndërtesa është që më kanë trajtuar,
5 e aty më kanë mbajtur, në bodrum poshtë.

6 Py. Faleminderit shumë. Ka edhe një rreth më të vogël, nuk e
7 di a sheh dot. Është kjo ndërtesa e madhe. Pastaj ka edhe një
8 rreth tjetër, më të vogël në pjesën e fundit, në anën e majtë
9 të kësaj ndërtesës, ke bërë një rreth të vogël. E dallon atë?

10 Pë. Jo.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju lutem zmadhojeni pak
12 fotografinë sepse ky rrethi është bërë me një laps ngjyrë blu.
13 Mbase nuk shihet mirë. Shihe, në krahun e majtë aty në cep.

14 Py. Z. Dëshmitar, e sheh dot rrethin e vogël, brenda rrethit
15 të madh?

16 Pë. Po.

17 Py. Çfarë tregon ai rrethi i vogël?

18 Pë. Tregon se në atë derën aty jam trajtuar.

19 Py. Dje na tregove, na fole për ditën kur të kanë liruar. Nga
20 ajo dera ke dalë kur të kanë liruar, a të kujtohet?

21 Pë. Jo.

22 Py. Nuk e mban mend apo nuk ju kanë liruar, nuk ju kanë lënë
23 me dal nga ajo dera aty, cila është përgjigja?

24 Pë. Jo, por s'na ka kanë lejuar me kqyr hiç, veç na kanë
25 nxjerrë për dera dhe na kanë thënë "hipni këtu, mos këqyrni

1 hiç. Ku të doni shkoni".

2 Py. E kuptoj. Tani do të të tregoj një fotografi tjetër.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Numri i kësaj fotografie për
4 procesverbal është SITF0072231. Por nuk duhet ta transmetojmë
5 për publikun, vetëm dëshmitari dhe ne që jemi këtu në sallën e
6 gjyqit. Paragrafi 9.

7 Py. Z. Dëshmitar, a e sheh këtë fotografinë këtu?

8 Pë. Po.

9 Py. A e dallon nënshkrimin tënd aty, e sheh?

10 Pë. Po.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, është e
12 njëjta fotografi që është bërë në të njëjtën kohë por
13 dëshmitarit ja treguam gjatë një interviste tjetër.

14 Py. Z. Dëshmitar, a të kujtohet që ta kanë kallëzuar këtë
15 fotografi gjatë intervistës me UNMIK-un në vitin [REDAKTUAR]?

16 Pë. Po.

17 Py. Një pyetje përpara se të vazhdojmë më tej. Të lutem
18 mundohu të kujtosh atë çastin, momentin kur të kanë liruar, që
19 na tregove dje, që na the se përjashta kishte shumë njerëz.

20 Kështu ka qenë?

21 Pë. Po unë e thashë dje, kur jam dolë prej atyhit, kam parë
22 shumë njerëz në oborr, jashtë. Dhe më veç kena kqyr me ik, ka
23 kena mujt. Kena pasur frikë se po na kthenin apet mrena aty e
24 po na mbajnë. As kur jom shku në shtëpinë, as nuk më ka
25 interesu kurrgjë hiç. Veç më ka interesu jeta jeme me shpëtu.

1 Py. E kuptova, por dje na the se e dija vendin se ku po të
2 çonin. Po diskutonim dje, po flisnim dje që the se e dije se
3 ku ishe, e dije se ku po shkoje, e përmende emrin e këtij
4 vendi. Mbasi të liruan, tani të përqendrohemi tek lirimi, a
5 pate ndonjë moment kur ti ishe në këtë grup njerëzish, që të
6 shikoje përreth. A nuk hodhe njëherë sytë përreth për të parë
7 se ku ishe? Nuk ndodhi që të shikoje se ku ishe?

8 Pë. Me thonë drejtë, ka qenë gjendje lufte, kurrkujt s'i ka
9 interesu për kërrkënd, veç secili ka kqyr vetveten, sa më
10 shpejtë me ikë, me u msheh se në atë ditë që jam dalë, a konë
11 ofensiva.

12 Py. Po, e kuptoj, por njëkohësisht edhe sot edhe në vitin

13 [REDAKTUAR], kur ja ke dhënë deklaratën UNMIK-ut por edhe në
vitin

14 [REDAKTUAR], kur i ke dhënë deklaratë Prokurorit, por edhe në
vitin

15 [REDAKTUAR], pra më herët këtë vit kur ke dhënë tjetër
deklaratë, ti

16 ke thënë se kjo ishte ndërtesa ku të kanë mbajtur dhe ne duam
17 të dimë nga e di ti që ishte kjo ndërtesa ku të kanë mbajtur?

18 Pë. Po normal po e di se une nuk kam kqyr krejt, por kam kqyr
19 pak që me dit ku jom konë.

20 Py. A e pe mjaftueshëm këtë ndërtesë për ta njohur pastaj në
21 një fotografi, pra në këto fotografi më vonë?

22 Pë. Po.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj
24 që dëshmitarit t'i tregojmë një tjetër dokument por edhe një
25 herë dua t'i lutem Sekretares të mos ja parëse, mos t'ja

1 tregojë publikut. Është një sakicë me numër ERN061013, me gamë
2 ERN 061012 deri në 061015. Edhe përkthimi në gjuhën shqipe
3 gjithashtu. Është nën-ndarja 11.

4 Py. Z. Dëshmitar, a e sheh atë skicën, atë vizatimin aty
5 përpara?

6 Pë. Po.

7 Py. Nënshkrimi a është i yti, ai aty poshtë?

8 Pë. Po.

9 Py. A mund t'u thuash Gjykatësve se çfarë tregon ky vizatim?

10 Pë. Po vallahi drejt me fol, kjo është një kohë kaq e shumtë
11 dhe pak kam harruar, nuk -- nuk e di. Normal, që ajo shtëpia
12 por s'po di. Kam ndenjur - po shihet si derë, nalt [e
13 pakuptueshme] q'ashtu jam munduar me ba, besoj.

14 Py. Në këtë vizatim, është numri 2 pak më lartë, majtas,
15 është si në katror aty i ndarë në dy pjesë. Pjesa e sipërme
16 është shënuar me 2, pastaj është pjesa e poshtë. A të kujtohet
17 se çfarë janë, domethënë çfarë është kjo pjesa e sipërme dhe
18 pjesa e poshtme, pra çfarë tregon ai 2 dhe 1 në vizatim?

19 Pë. Po këtu jam munue me tregu se poshtë kam nejt unë, nalt
20 ka nejt -- a kanë tjetër dhomë.

21 Py. Tjera dhomë -- sepse në këtë vizatim faktikisht është
22 shkruar në anglisht aty është vizatuar në anglisht dhe në
23 anglisht është shkruar "është dhoma e rrahjeve" dhe numri 1
24 është numri në anglisht "stalla". Pra këtë ke dashur të
25 tregosh në këtë vizatim që në atë dhomën sipër?

1 Pë. Poshtë kena nejt -- kena ndejt na, e në dhomën nalt ka
2 ndejt ushtria, ushtarët, policët, sepse unë nuk e di ata --
3 Py. Të kuptova. Një tjetër vizatim dua të të tregoj, vizatimi
4 i fundit.

5 I falënderoj Gjykatësit për durimin që po tregoj, mbase
6 po marr shumë kohë por duhet që ta shohim këtë gjë. A mund t'i
7 tregojmë dëshmitarit një tjetër vizatim. Numri është 061014.
8 Të gjej edhe serinë, numri e serisë, në fakte është po e
9 njëjta si më parë. Nga 061012 deri në 061015, nën-ndarja
10 njësoj si më parë është nr. 11. Dua edhe këtë vetëm
11 dëshmitarit t'ja tregojmë.

12 Py. Z. Dëshmitar, a e sheh nënshkrimin tënd poshtë vizatimit?

13 Pë. Po.

14 Py. A të kujtohet që e ke bërë vetë këtë vizatim?

15 Pë. Po.

16 Py. Siç mund ta shohësh, ka dy pjesë, duhet të na flasësh për
17 këto, por djathtas, ke përmendur emrin e dikujt. Çfarë është
18 ky emër, a mund t'ja tregosh Gjykatësve?

19 Pë. Po, ky ishte komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
20 Është Fatmir Sopi.

21 Py. Për këtë person, për këtë njeri nuk do të bëj pyetje, por
22 dua tani që të flasim për pjesën tjetër të këtij vizatimi.
23 Çfarë emri ka në të majtë të këtij vizatimi?

24 Pë. Po vallahi, s'po di. Se s'po më kujtohet fort.

25 Py. Ky vizatim ka disa gjëra aty brenda. Kështu që shiko

1 majtas, në të majtë të vizatimit, në pjesën e poshtme, pra në
2 qoshen poshtë. Çfarë emri ke shkruar ti aty? Cili është ai
3 emër?

4 Pë. S'po munem me e kuptu.

5 Py. Mbase nuk të kujtohet, po vizatimi është i yti, por në
6 pjesën e poshtme majtas, në qoshen majtas poshtë, ke shkruar
7 një emër. A e lexon atë emër aty, cili është ai emër?

8 Pë. E kuptoj. Ky është emri i të akuzuarit. Emrin, e kam
9 thënë edhe dje, nuk muj me ja përmend, dhe as du me ja
10 përmend, në jetë.

11 Py. Të kuptova. Këtë vizatim e ke ndarë në dysh. Nga ana e
12 djathtë ke shkruar aty Fatmir Sopi, në anën tjetër, siç e the,
13 është emri i të akuzuarit. Po ky vizatim çfarë tregon, mund
14 t'ja thuash Gjykatësve?

15 Pë. Po ky vizatim tregon, atëherë kam dhënë deklaratën se
16 këto dy vende që janë, dy vende, janë diku në afërsi 1
17 kilometër larg njëri-tjetrit. Domethënë në anën e djathtë, kur
18 a konë ushtria e rregullt, a këtu janë konë policia ushtarake.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam nevojë
20 një sekondë për një konsultim shumë të shkurtër.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
22 pa problem.

23 [Prokurorët këshillohen]

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kam pyetje për këtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdimi) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493 Marrje në pyetje nga Z. Michalczuk Faqe 28
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 vizatim, por kam pyetje të tjera për disa gjëra të tjera të
2 cilat kanë të bëjnë me rezultatin, me pasojat e qëndrimit e
3 dëshmitarit në Zllash, kështu që kam disa pyetje, kështu kam
4 parasysht edhe orën.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Përpara se të filloni me këtë, i nderuar Prokuror, po bëni
7 disa pyetje. Mund të kalojmë në seancë private dhe mund t'i
8 jepni garanci dëshmitarit lidhur me këtë. Jua lë juve në dorë
9 sigurisht, por po jua ofroj këtë si mundësi.

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Kërkoj të kalojmë në seancë
11 private, por shumë shkurt. Thjesht për të cekur nja dy gjëra
12 pastaj mund të kalojmë përsëri në seancë publike.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit. Zonja Sekretare a mund të na kaloni në seancë
15 private ju lutem?

16 ~~{Seancë private}~~ [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
18 jemi në seancë private.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Faleminderit.

21 Zoti Prokuror, keni fjalën.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit, të nderur
23 Gjykatës.

24 Py. Z. Dëshmitar, dua t'ju garantoj që tani je në seancë
25 private, askush nuk ju sheh, askush nuk ju dëgjon, vetëm

1 personat që janë në këtë sallë mund t'ju dëgjojnë kështu që të
2 jeni i sigurt që asgjë nuk do të dalë nga kjo sallë. E kupton
3 këtë?

4 Pë. Po.

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirë, tani që morëm këtë
22 përgjigje, mund të kalojmë në seancë të hapur.

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARJA E GJYKATËS [Përkthim] Jemi përsëri në seancë
25 të hapur, të nderuar Gjykatës.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

2 Prokuror, keni fjalën.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a i kemi

4 edhe dhjetë minuta?

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Keni

6 edhe dhjetë minuta.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirë atëherë do të bëj disa

8 pyetje të cilat mund të bëhen në seancë ë hapur. Pastaj do

9 bëjmë pushimin dhe mbas pushimit do ju kërkoj që të kalojmë në

10 seancë private për pyetjet që kanë mbetur.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

12 keni fjalën mbas orës 11.30?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

15 mund të vazhdoni.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.

17 Py. Z. Dëshmitar, vazhdojmë. Dua që t'ju bëj disa pyetje që

18 kanë të bëjnë me pasojat për shëndetin tënd për shkak të

19 qëndrimit në Zllash, pyetja e parë: çfarë lëndimesh pate si

20 pasojë e gjërave që të kanë ndodhur në Zllash?

21 Pë. Këtë [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]. Pastaj, mbasi më

23 lirunë, nuk e kom ditë momentalisht -- nuk e kom ditë,

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR] Jam bo me tetë

3 komça i kom këtu -- shaku i rrahjes që kam pasur.

4 Pasojat janë këtu - [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR].

6 Py. T'i marrim një për një. Së pari. Përmende [REDAKTUAR] dhe

7 e kuptoj që tregove [REDAKTUAR].

8 Pë. Jam konë n'mjek normal jam konë në Prishtinë. A

9 [REDAKTUAR] i kam bërë në [REDAKTUAR]

10 Py. Jo, të kuptoj, jo, jo. T'i marrim një për një. Të flasim

11 njëherë për [REDAKTUAR]. Pak më parë na tregove [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR], kështu? Është e saktë kjo që na tregove

13 [REDAKTUAR] që pate aty lëndime?

14 Pë. Po.

15 Py. Na tregove pastaj edhe [REDAKTUAR]

16 Pë. Po. [REDAKTUAR] Në tre vende. Nuk

17 jam as për punë. S' [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR], edhe nga qe kjo Gjykatë kërkoj dëmshpërblim. Se

19 kam nevojë se më ka bërë gjysmë njeri.

20 Py. Z. Dëshmitar, na ke përmendur edhe një [REDAKTUAR] të

21 thyer, a të dëmtuar. Për cilin [REDAKTUAR] po flasim?

22 Pë. Kjo. Kjo.

23 Py. Pra, gishti [REDAKTUAR], e saktë?

24 Pë. Po.

25 Py. Na përmende pak më parë disa [REDAKTUAR], kështu?

1 Pë. Po.

2 Py. A mundesh me i tregu Gjykatësve se në cilën pjesë

3 [REDAKTUAR] je lënduar? Përmende edhe [REDAKTUAR], ku je bërë

4 [REDAKTUAR], në cilën [REDAKTUAR]?

5 Pë. Këtu e kam, shenjën e kam. [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]. E din, këtu ku [REDAKTUAR].

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

8 Prokuror, dëshiroj që të shënojmë në procesverbal që zoti

9 Dëshmitar po tregon me gisht në [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po.

12 Py. Pak më vonë do t'i kthehemi kësaj pjese, pra për

13 [REDAKTUAR] që ke bërë më pas, këtë po e bëjmë në

14 seancë private, por përpara kësaj dua të të bëj një pyetje.

15 Menjëherë mbasi je liruar nga Zllashi, kujtohu pak a more

16 ndonjë farë mjekimi? Nuk po flas në spital, por diku në ndonjë

17 ambient privat?

18 Pë. Po, mbas një kohe, një herë nuk ka pasur mjekësi të

19 rregullt. Se ka qenë gjendje lufte dhe s'kam mujt kërrkund me

20 u kontrollu as me u shëru. Pastaj, mbas një kohe, [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR] -

22 [REDAKTUAR]. Masanej, e ka bo [REDAKTUAR] e

23 ka thënë [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR].

25 Py. Do ta diskutojmë pak më vonë. Pyetjen e kam, trajtim

1 menjëherë, diçka menjëherë mbas lirimit, mbasi të kanë lëshuar
2 prej Zllashit. Se ti the që ishe i lënduar. Kishe disa -- prit
3 pak. Pra the që kishte [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR] pra para se të shkoje në spital, çfarë
5 trajtimi i bëre këtyre, si i mjekove këto?

6 Pë. Kam bo në atë kohë trajtim në shtëpinë time mrena, me
7 lloje-lloje, qysh me t'fol, katunarçe, qysh bojmë, se nuk ka
8 pasur mjekë. Ka pasur, por s'ka pasur mjekë që të kanë
9 kontrollue. E kadal-kadalë, masanej u futa me u shëru te
10 dikun.

11 Py. Përmende edhe që të ishin dëmtuar [REDAKTUAR]. A mund t'u
12 tregosh Gjykatësve më shumë se çfarë u ka ndodhur [REDAKTUAR],
13 çfarë lëndimesh ishin te [REDAKTUAR]?

14 Pë. Po [REDAKTUAR], që këtu i kam një vidë,
15 dihet q'këtu. Qi këtu që [REDAKTUAR] me shkelma, tu m'sjell,
16 nuk e di me çka m'kanë sjellë, nuk e di, s'muj me e ditë. Dhe
17 kam pasur [REDAKTUAR]. Dhe kam pas edhe kështu
18 edhe [REDAKTUAR] të lëndume, në një kohë ka shkuar kah tre
19 katër muaj, s'jam shëruar. Hala nuk jam shëruar siç duhet.

20 Py. A ke bërë ndonjë mjekim për të rregulluar [REDAKTUAR]?

21 Pë. Po.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë ato
23 pyetje që thashë që do t'i bëja para pauzës kaq ishin, në
24 seancë të hapur, por do t'i kthehem kësaj teme më me imtësi
25 pas pauzës në seancë private.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W03593 (Vazhdimi) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në pyetje nga Z. Michalczuk
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

Faqe 34

1 RYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, zoti prokuror.

3 Ka ardhur ora për pushimin e parë. I kërkoj shoqërueses
4 që të shoqërojë dëshmitarin që të dalë nga salla.

5 Do të rifillojmë pas 30 minutash.

6 [Dëshmitari del nga salla]

7 --- Pauza filloi në orën 10.57.

8 --- Seanca rifillon në orën 11.29.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Uluni ju lutem.

10 Mirë se keni ardhur përsëri. Rifillojmë dëshminë e Dëshmitarit
11 3593 dhe do vazhdojmë në seancë private besoj prokuror?

12 Z. MICHALCZUK: Po, e nderuar.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

14 Sekretare të lutem kërko të kalojmë në seancë private.

15 [~~Seancë private~~] [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit. Tani silleni ju lutem dëshmitarin.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Përpara se të vijë dëshmitari
20 dua t'ju njoftoj se pyetjet tona do të përfundojnë sot përpara
21 drekte, të paktën ky është synimi ynë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 [Dëshmitari hyn në sallë]

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

1 se ke ardhur përsëri z. Dëshmitar. Përpara se t'i jap fjalën
2 Prokurorit të Specializuar, dëshiroj që të them këto gjëra.

3 Sot në mëngjes nuk e regjistrova për procesverbal praninë
4 e Zyrës Administrative. Pra tani e kemi shënuar që Z. Roche
5 është i pranishëm.

6 Duke parë ekipet shoh që janë të njëjtët persona. Po në
7 rregull. Në rregull z. Prokuror keni fjalën.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë.

9 Py. Z. Dëshmitar, a mund të vazhdojmë? Kam edhe disa pyetje të
10 fundit për ty.

11 Përpara pushimit po diskutonim për ato lëndimet që ke
12 pësuar. Ti the se je [REDAKTUAR] midis të tjerash. Kam disa
13 pyetje lidhur me këtë [REDAKTUAR]. Më herët na
14 the që ke bërë [REDAKTUAR]. Kështu ka
15 qenë?

16 Pë. Po.

17 Py. Përpara se të vazhdojmë dua t'ju kujtoj që jemi në seancë
18 private Dëshmitar, prandaj ato që do thuash ti do të mbeten
19 këtu brenda, nuk do dalin jashtë gjykatës, e kupton?

20 Pë. Po.

21 Py. Z. Dëshmitar, a e mban mend se ku ke shku për [REDAKTUAR]
22 [REDAKTUAR]? Ku je trajtu?

23 Pë. [REDAKTUAR]

24 Py. Kur ke bërë atë [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR], të kanë dhënë disa letra që ke bërë [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdimi) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në pyetje nga Z. Michalczuk Faqe 36
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Po.

2 Py. A të kujtohet t'ja kesh dhënë këto letrat që të dha
3 spitali Prokurorisë gjatë intervistës që të ka bo.

4 Pë. Po.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dëshiroj që
6 t'i tregoj dëshmitarit vetëm një dokument dhe numri i
7 dokumentit është ky SITF00296103 deri 00296121 dhe ky është
8 numri i gjuhës shqipe. Në anglisht është i njëjti numër po ka
9 në fund -ET.

10 Dua t'i tregoj dëshmitarit një dokument që gjendet në
11 faqen SITF00296103 me versionin përkatës korrespondues në
12 anglisht.

13 Ju lutem t'ja tregojmë dëshmitarit këtë dokument.

14 Py. Z. Dëshmitar, e ke përpara dokumentin aty në ekran?

15 Pë. Po.

16 Py. A e njef këtë dokument si një nga dokumentet që ia ke
17 dhënë Prokurorisë gjatë intervistës?

18 Pë. Po.

19 Py. Dua të të bëj një pyetje, kur [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR], çfarë u the doktorëve për mënyrën se si ishe
21 lënduar, se si e kishe marrë atë plagën?

22 Pë. Po me ju thonë të drejtën, doktorit i kom thonë jom ra
23 dikund, jam rrëzue, kam [REDAKTUAR], se më ka ardhë marre me
24 thënë që më kanë lëndue UÇK-ja.

25 Py. Pra arsyeja pse nuk i tregove doktorëve se si i kishe

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W03593 (Vazhdimi) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Marrje në pyetje nga Z. Michalczuk Faqe 37
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 marrë ato lëndime, kush t'i kishte bo, ishte se kishte turp, të

2 vinte marre me ju thanë se ça kish ndodhur aty, kështu?

3 Pë. Po, më ka ardhë marre.

4 Py. Faleminderit shumë.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës nuk do t'i
